





# HAXHI

Udhëtimi i jetës

Pas mbërritjes në Mekë	Bëj Tavafin
Dita 8 Dhul-Hixhe	Veshja e <i>Ihramit</i> Qëndrimi në Mina
Dita 9 Dhul-Hixhe	Qëndrimi në <i>Arafat</i> Qëndrimi në <i>Muzdelife</i>
Dita 10 Dhul-Hixhe	Gjuajtja e gurëve Prerja e Kurbanit ( <i>Ud'hiye</i> ) Rruajtja e kokës <i>Tavafu-l-Ifada</i> ( <i>Tavafi i Haxhit</i> )
Dita 11, 12, (13 Dhul-Hixhe)	Qëndrimi në Mina për gjuajtjen e gurëve
Para largimit nga Meka	<i>Tavafu-l-Veda</i> ( <i>Tavafi i lamtumirës</i> )

## Dita e 8-të e Dhul-Hixhes (Jevmu-t-Tervije)

Hyni në gjendjen e ihramit (për Haxh).<sup>6</sup>

◆ Bëni nijetin, duke thënë:

لَبَّيْكَ اللَّهُمَّ بِحَجِّ

“Lebbejke Allahumme bi-Haxh-xhin”

“Këtu jam o Allah, (në përgjigje të thirrjes Tënde) duke bërë Haxhin!”

Duke qëndruar, në drejtim të Kibles thuaj Telbijen:


“Lebbejke Allahumme Lebbejke, Lebbejke la sherike leke Lebbejke, Inne-l-hamde, venni'mete, leke ve-l-mulk, La sherike lek”.

◆ Midis periudhës kohore: pas agimit deri në lindjen e diellit, mund të shkohet në Mina (preferohet në mëngjes).

## Qëndrimi në Mina

◆ Falja e drekës, Ikindisë, Akshamit dhe Jacisë në Mina.

◆ Të jesh i lidhur me ibadetet, adhurimet gjatë gjithë ditës.



## Dita e 9-të e Dhul-Hixhes (Dita e Arafatit)

### Qëndrimi në Arafat

◆ Ditën e 9-të bëjmë faljen e sabahut në Mina. Me pas nisemi për në Arafat pas lindjes së diellit.



Ndaloni nëse është e mundur në *Nemira*<sup>7</sup> (vend afër Arafatit – ku ndodhet xhamia tani) dhe qëndroni aty deri pas *zevalit* (kur dielli ndodhet në pikën më të lartë – s'ka hije) dhe dëgjoni hudben! Në qoftë se nuk është e mundur, është e lejueshme të qëndroni kudo në Arafat, deri kur të perëndojë dielli. Këshillohet të qëndroni të shkëmbinjtë në fund të Kodrës së Mëshirës (Jabalu-r-Rahmeh); nëse jo, pastaj i gjithë Arafati është vendi i qëndrimit. Drejtuar nga Kibla, me duar të ngritura, bëni lutje (dua) dhe recitoni Telbijen. Këshillohet që vazhdimisht të thuhet duaja, si më poshtë:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ، وَ لَهُ الْحَمْدُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

“La ilahe il-Allahuh vahdehu la sherike lehu lehu-l-mulku ve lehu-l-hamdu ve huve ala kul-li shej'in kadir”.


“Nuk ka Zot tjetër të adhuruar përveç Allahut, Ai është Një e i Vetëm! Atij i takojnë falënderimet dhe lavdërimet dhe Ai është i Gjithëfuqishmi për çdo gjë!”.

- Kjo është duaja më e mirë për t'u thënë në këtë ditë të madhe.

- ◆ Në Arafat duhet të falni Drekin dhe Ikindinë.<sup>8</sup>
- ◆ Qëndroni (VUKUF) në Arafat dhe faluni, bëni dua (lutje) dhe kërkoni falje deri në perëndim të Diellit!
- ◆ Pas perëndimit shkoni në Muzdelife!

## Qëndrimi në Muzdelife

◆ Në Muzdelife falni akshamin dhe jacinë bashkë!<sup>8</sup>



◆ Mbledhja e 70 guralecëve që do na duhen për gurëzim gjithashtu bëhet në Muzdelife, ose Mina.<sup>9</sup>

◆ Kaloni natën me ibadet (adhurim), ose shkoni për të fjetur deri në sabah.

## Dita e 10-të e Dhul-Hixhes (Jevmun-Nehr)

◆ Falja e Sabahut në Muzdelife.

◆ Largimi për në Mina bëhet pas Sabahut.

Midis periudhave kohore: pas lindjes së diellit deri natën, qetësisht procedohet me hedhjen e gurëve në Xhemretu-l-Akebe.<sup>9</sup>

Gjatë hedhjes së 7 gurëve pozicionohemi duke lënë Mekën në anën e majtë dhe Minan në të djathtë, e duke thënë:

اللَّهُ أَكْبَرُ - Allahu Ekber

Allahu është më i Madhi (pas çdo gjuajtje)!



◆ *Prerja e Kurbanit* (Sakrificës),

Në shumicën e rasteve kurbanet porositi me kupona (nga agjencitë përkatëse), kjo është një alternativë e lejueshme, përndryshe, mund të bëni prerjen e kurbanit edhe në Mina, po patet kushte për këtë.



◆ *Rruani - Shkurtoni flokët* ✂. Pas prerjes së Kurbanit, për *burat*: rruajtja e kokës është e preferueshme, ose mund të prisni flokët njëtrajtësisht në të gjithë kokën; Kurse *gratë* presin pak nga flokët.

◆ Pas prerjes së flokëve mund të hiqni ihramin, pasi disa nga kufizimet që kishit më parë janë hequr. Më pas shkoni në Mekë për të bërë Tavafu-l-ifada.

## Tavafu-l-ifada

◆ Për të bërë Tavafu-l-ifada shkojmë në Mekë. Ai mund të bëhet në çdo kohë (ditën ose natën) deri në perëndim të ditës së 12 Dhul Hixhe.<sup>10</sup>

Pas hyrjes në xhaminë e Qabes (Harem) me këmbën e djathtë, thoni: duanë e hyrjes në xhami (shiko seksionin e Umres në faqen e parë!). Për të bërë këtë tavaf nuk është i nevojshëm ihrami. Tavafin e filloni nga Guri i zi.<sup>11</sup>

◆ Pasi tavafi është plotësuar, falni 2 rekate para vendqëndrimit të Ibrahimit, ose kudo në Harem. Thoni: suren El-Kafirun në rekatin e parë dhe suren El-Ihlas në rekatin e dytë.



◆ Pini ujë Zemzemi – Bëni lutje (Dua)!


◆ Bëni Sa'jin (shikon seksionin e Umres në faqen e parë!)

◆ Pas përfundimit të Sa'jit, të gjitha kufizimet lashmë janë hequr.

◆ Pas largimit nga xhamia e Qabes kthehuni në Mina dhe mos harroni të thoni duanë e largimit nga xhamia (shikoni seksionin e Umres në faqen e parë)!

## Ditave e 11-të Dhul-Hixhe

### Qëndrimi në Mina për gjuajtjen e gurëve



Nga koha midis Zenitit (kur dielli është në pikën kulmore, s'ka hije) deri edhe natën, gjuni me gurë 3 Xhemeratet, nga 21 gurë çdo ditë.<sup>12</sup> 3 2 1

Gurët hidhen nga 7 në gjithsecilën Xhemere, duke pasur Mekën në anën e majtë dhe Minan në të djathtë, e duke thënë:

اللَّهُ أَكْبَرُ - Allahu Ekber

Allahu është më i Madhi (pas çdo gjuajtje)!

Pas gjuajtjes së Xhemeres së parë 1, kthehuni nga Kibla ngrini duart dhe lutuni si të dëshironi. Duke pasur përpara xhemeren e dytë 2, Meken në anën e majtë dhe Minan në anën e djathtë, hidhni 7 gurët duke thënë:

اللَّهُ أَكْبَرُ - Allahu Ekber

Allahu është më i Madhi (pas çdo gjuajtje)!

Pas kësaj gjuajtje, kthehuni nga Kibla, ngrini duart dhe lutuni si të dëshironi! Kështu do të veproni edhe me Xhemren e tretë, 3 duke pasur Mekën në anën e majtë dhe Minan në anën e djathtë, hidhni 7 gurët duke thënë:

اللَّهُ أَكْبَرُ - Allahu Ekber

Allahu është më i Madhi (pas çdo gjuajtje)!

Pas mbarimit të gjuajtjes së Xhemres së fundit, lëvizni drejt (largohuni) pa bërë ndonjë dua e lutje.

## Dita e 12-të Dhul-Hixhe

◆ Në periudhën kohore pas Zenitit (pas mesditës) e deri natën, do të gjuni të tre Xhemeratet me nga 7 gurë secilën, duke kryer të njëjtat rituale e lutje si ditën e mëparshme.

Largohuni nga Mina për në Mekë para perëndimit, nëse është e mundur. Në qoftë se nuk mund të largoheni, atëherë qëndroni në Mina.

## Dita e 13-të Dhul-Hixhe

◆ Në qoftë se nuk largoheni nga Mina, atëherë do të gjuni gurët edhe ditën e 13-të. Është mirë të filloni pas agimit. Do të gjuni të tre Xhemeratet me nga 7 gurë secilën, duke kryer të njëjtat rituale e lutje si ditën e mëparshme.

◆ Këtu kanë përfunduar të gjitha ritualet e Haxhit në Mina, prandaj largohuni për në Mekë, ku mund të rini sa të dëshironi (sa është parashikuar nga agjencia juaj e Haxhit).

◆ Para se të largoheni nga Meka, bëni *Tavafin-Veda*<sup>13</sup> (Tavafi i lamtumirës), pasi është e pëlqyeshme që ky të jetë veprimi i fundit në këtë qytet të shenjtë.

## Shënime:

<sup>6</sup> Nga kudo që të jeni me banim (qëndrim): hotel, shtëpi, etj.

<sup>7</sup> Nemire është një vend në skaj të Arafatit, tani aty ndodhet një xhami. Nëse aty nuk gjeni vend, është e lejueshme për të qëndruar kudo tjetër në brendësi të Arafatit.

<sup>8</sup> Farzet falen nga dy rekate secili. Kjo vlen për drekin, ikindinë dhe Jacinë. Akshami nuk shkurtohet, prandaj ai falet tre rekate. Sigurisht, Jacia duhet të ndiqet edhe nga namazi i Vitrit.

<sup>9</sup> Është e pëlqyeshme që gurët të jenë të gjithë në të njëjtën madhësi (por nuk është e domosdoshme), afërsisht sa lajthia (1cm = 0.39 inç). Gurët mund të merren edhe në Mina.

<sup>10</sup> *Tavafu-l-ifada* (Tavafu-z-Zijare) mund të bëhet deri në ditën e 12-të të Dhul-Hixhe-s. \*Gratë kanë akoma më shumë ditë shtesë për të kryer Tavafin në rastin kur ato janë me menstruacione.

<sup>11</sup> Sqarimet për Tavafin, shikojni në faqen e parë kur shpjeguar ritualin e Umres!

<sup>12</sup> Do t'ju nevojiten 7 guralecë në ditën e parë (10 Dhul-Hixhe), dhe 42 gurë për dy ditët tjera (gjithsej 49). Është mirë të keni edhe 21 guralecë ekstra në rast se qëndroni në Mina edhe ditën e 13 Dhul-Hixhe (me këto bëhen 70 gjithsej).

<sup>13</sup> Është e lejueshme për të kryer Tavafu-l-Veda-në edhe ditën e 12-të të Dhul Hixhes (nëse ju largoheni nga Mina para perëndimit të diellit). Në këtë rast ju keni humbur një ditë të rekomanduar (por jo të detyrueshme) të hedhjes së gurëve.

## Udhëtimi me metro gjatë Haxhit

Pelegrinët e Haxhit që udhëtojnë me metro (tren) do të shkojnë në Arafat e më pas Muzdelife, Mina dhe në Xhemerate me tre stacionet në formë cadre për çdo zonë, bazuar në byzlykët me ngjyra që më parë lu janë dhënë haxhinjve. (Byzlykët e ngjyrosur para Haxhit).



Stacioni 1- Blu	Stacioni 2- Verdhë	Stacioni 3 - Jeshil
M i n a 1	M i n a 2	Xhemerat (Mina) 3
A r a f a t 1	Muzdelife 2	Muzdelife 3
Muzdelife 1	A r a f a t 2	Arafat (Mina) 3

Haxh Mebrur

Allahu (xh.sh.) ua pranofte Haxhin!

رقم اذن بطبع ٥٢٠٩م/ج في ٣٠/١٢/١٤٣١

انجليزي English

[www.islamicbulletin.org](http://www.islamicbulletin.org)